

PRINCIPATA E BALSHAJVE SI DHE ROLI I TYRE NË RIFORCIMIN E KISHËS KATOLIKE NË TROJET ARBËRORE

Besim MORINA¹

Abstract

The Balsha principality emerged as a state formation with significant political influence in the northern Arbëria territories in the early 1360s and became a weighty factor in economic, political, and military life. The Balsha's possessions included a vast territory of Arbëria lands that stretched from the borders of Budva in the north to those of Himara in the south, from the Adriatic in the west to Kriva Rijeka and Kostur in the east. Their possessions also extended to the city of Peja, Prizren, and Kriva Rreka, near Novoberda. During the Balsha's rule, religious objects were built in the areas around Lake Shkodra, in the region of Krajina, in Ulcinj, Tivar, and Budva. In present-day Kosovo, the influence of the Balsha principality also extended to the Christian organization. Thus, members of this family during the years 1375 to 1385 led the church councils in the Patriarchate of Peja. Also, during their time, the city of Prizren gained a Catholic bishop.

Keywords: Balsha; Arbëria; principality; origin; territory; papacy; alliances; Catholic Church.

Përmbledhje

Principata e Balshajve doli si një formacion shtetëror, me rol të rëndësishëm politik në trojet e Arbërisë së Veriut në fillim të viteve 60- të të shekullit XIV dhe u bë faktorë me peshë në jetën ekonomike politike dhe ushtarake. Zotërimet e Balshajve përfshinin një territor të gjerë trojesh arbërore që shkonte nga kufijtë e Budës në veri, deri te ato të Himarës në jug, prej Adriatikut në perëndim, deri të Kosturi në lindje. Zotërimet e tyre u shtrinë edhe në qytetin e Pejës, Prizrenit dhe deri në Kriva Rekë, pranë Novobërdës.

Gjatë sundimit të Balshajve, u ndërtuan objekte religjioze në zonat rreth Liqenit të Shkodrës, në krahinën e Krajës, në Ulqin, Tivar dhe Budua. Në Kosovën e sotme, ndikimin e vet Balshajt e shtrinë edhe në organizimin kishtar. Kështu, pjesëtarët e kësaj familje në vitet 1375 dhe 1385, udhëhoqën kuvendet kishtarë në Patriarkanën e Pejës. Gjithashtu, në kohën e tyre, qyteti i Prizrenit fitoi një ipeshkëv katolik.

Fjalët kyçe: Balshajt, Arbëria, principata, prejardhja, territori, papati, aleancat, Kisha Katolike.

Lidhur me prejardhjen e familjes Balshaj ekzistojnë mendime të ndryshme. Prejardhja e tyre është e pa qartë,³⁹ ndërsa për disa studiues, Balshajt ishin francezë,⁴⁰ për të tjerët serbë,⁴¹ Šufflay mendon se janë me zanafillë rumune a vllahe dhe e mbanin vetën si arbërorë,⁴² dhe

³⁹ M. Пурковић, *Авиџонске пале и српске земље*, Пожаревац, 1934, 74.

⁴⁰ Zh. K. Faveirial, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë, 2004, 257; Č. Mijatović, "Balšići (Skice za istoriju Zete)", në: *Glasnik srpskog učenog društva*, knj. 49, Beograd, 1881, 145-150.

⁴¹ Đ. Stratimirović, "O Balšićima", në: *Godišnjica Nikole Čupića*, knj. XV, Beograd, 1895, 174-180.

⁴² M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2002, 26, 238; Vllehë të sllavizuar, në: *Istoriya Crne Gore*, II, Titograd, 1970, 7.

flisnin si arbërorët,⁴³ kurse Malcolm mbron mendimin se ishin shqiptarë por të sllavizuar në një shkallë të lartë,⁴⁴ ndërsa Ćirković, i cili mohon prejardhjen sllave të Balshajve, përmend zakonte arbërore të Gjergjit I Balsha.⁴⁵ Balshajt ishin arbëror,⁴⁶ vetë fakti se, përkundër kancelarive sllave që mbanin në oborrin e tyre, ata flitnin në gjuhën arbërore, d.m.th. në gjuhën e nënës,⁴⁷ si dhe mos cenimi i zakoneve të vjetra në organizimin e jetës së arbërorëve,⁴⁸ fletë në mirë të prejardhjes së tyre arbërore.

Zotërimet fillestare të Balshajve u shtrinë në fshatin e Balëzës, në Malësin e Madhe pranë Shkodrës.⁴⁹ I pari i kësaj familje, njihej Balsha plaku, i cili përmendet në vitin 1356⁵⁰ dhe 1360,⁵¹ ishte zhupan në kohën e Stefan Dushanit.⁵² Pas shembjes së perandorisë rasiene të Dushanit (1355), popujt si grekët, bullgarët dhe arbërorët, filluan të lroheshin nga varësia e tyre.⁵³ Bujarët arbëror, të forcuar gjatë më tepër se dy shekujsh, si klasë sunduese, porsa u çliruan nga presioni i huaj bën përpjekje për zgjerimin e mëtejshëm të zotërimeve të tyre feudale dhe bashkimin e tokave arbërore në një shtet të vetëm.⁵⁴

Pakënaqësia e popullsisë arbërore, ndaj pushtuesve rasiën, u kthye në mbështetje të feudalëve arbëror.⁵⁵ Kështu, kryepeshkopi i Tivarit Guliem Adami, në relacionin e tij të vitit 1332, na njofton se Balshajt patën përkrahjen dhe mbështetjen e fuqishme të popullsisë vendase e cila urrente sundimin e huaj dhe të egër nemanjid.⁵⁶ Tani ishte hapur rruga për pavarësinë e plotë politike të klasës feudale arbërore.⁵⁷

⁴³ M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 238

⁴⁴ N. Malcolm, *Kosova- një histori e shkurtër*, Prishtinë- Tiranë, 2001, 63, 386.

⁴⁵ S. Ćirković, “Albanci u ogledalu južnoslovenskih izvora”, në: *Iliri i Albanci*, SANU (odelenje istoriskih nauka), XXXIX/10, Beograd, 1988, 336.

⁴⁶ *Acta Albaniae*, II, dok. 579; *Lufta shqiptaro-turke në shek. XV – Burime Osmane*, përgatitur për shtyp nga S. Pulaha, Tiranë, 1968, 296; S. Daci, “Forcimi i familjeve feudale dhe zotërimet e tyre në krahinën e Lezhës në shekujt XIII-XIV”, në: *Gjurmime albanologjike* (seria e shkencave historike), 13 - 1983, Prishtinë, 1984, 100; J. Tunmanin, “Kërkime në historinë e popujve të Evropës Lindore”, në: *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, përgatitur nga N. R. Çabej, Prishtinë, 1990, 58; P. Bogdani, “Kosova në shtetin feudal të shqiptar të Balshajve”, në: *E verteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë, 1990, 110-112; V. Jagić, “Konstantin Filozof i njegov život Stefana Lazarevića, despota srpskoga”, në: *Glasnik srpskog učenog društva*, 42, Beograd, 1875, 280, 313; *Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, Prishtinë, 1968, 210; P. Xhufi, “Shqiptarët e Jugut në betejën e Fushë-Kosovës”, në: *Beteja e Kosovës 1389* (Përmbledhje studimesh), Tiranë, 2005, 105; V. Shtylla, *Figura historike iliro-shqiptare*, Tiranë, 55; L. Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas (Aspekte të jetës së tyre)*, Tiranë, 1988, 47; R. Ushaku, *Ulqini në gjurmët e shekujve*, Ulqin, 1991, 18; I. Ruvarac, *O Knezu Lazaru*, Novi Sad, 1887, 410; K. Biçoku, Shfrytëzimi i masave fshatare gjatë sundimit venedikas, në: *Studime historike*, nr. 4, Tiranë, 1975, 122.

⁴⁷ Q. Dalipi, *Inkursionet osmane në trevat shqiptare deri më 1402*, Kërçovë, 2002, 65.

⁴⁸ I. Zamputi, Autonomitë e qyteteve shqiptare të principatës së Balshajve dhe pasojat negative të pushtimit venedikas – Fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV, në: *Studime historike*, nr. 3, Tiranë, 1980, 169-185.

⁴⁹ S. Daci, Forcimi i familjeve feudale dhe zotërimet e tyre ..., 100; P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve* ..., 23.

⁵⁰ Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355- 1443)*, Tetovë, 2012, 47

⁵¹ *Mala enciklopedija Prosveta*, treçe izdanje, br. 1, Beograd, 1978, 148.

⁵² B. Milutinović, Drivast u u vojno-političkoj situaciji XIV-XV veka (do 1478. godine), në: *Zbornik radova*, Filozofski Fakultet, nr. XXV, Prishtina, 1996, 383.

⁵³ F. Schevill, *Ballkani- histori dhe qytetërimi*, Tiranë, 2002, 143; Shih edhe: K. Frashëri, “Shqiptarët në betejën e Kosovës”, në: *Beteja e Kosovës 1389* (Përmbledhje studimesh), Tiranë, 2005, 114-115.

⁵⁴ A. Laurasi, *Shteti dhe drejta shqiptare në epokën e Skënderbeut*, Tiranë, 1998, 20.

⁵⁵ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve dhe e sundimtarëve të tjerë shqiptar kundër Venedikut në 20 vjetet e para të shekullit XV* (punim disertacioni, depozituar në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë), Tiranë, 1984, 29.

⁵⁶ *Burime të zgjedhura të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, shek. VIII-XV*, vëll. II, përgatitur për shtyp nga: A. Buda, I. Zamputi, Tiranë, 1962, dok. nr. 68, 111-112.

⁵⁷ P. Bogdani, “Prijet drejt bashkimit shtetëror të trojeve shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XIV dhe në fillim të shek. XV”, në: *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë, 1988, 122.

Kështu, anembanë trojeve arbërore, u mëkëmben formacione shtetërore arbërore të pavarura, si p. sh., Principata e Shkodrës, Principata e Durrësit, Despotati i Beratit, Despotati i Artës etj.⁵⁸ Bashkë me këto formacione dolën edhe një numër familjesh feudale, si, Balshajt, Topijajt dhe Muzakajt.⁵⁹ Secila nga këto familje, përmban një bërthamë të vërtetë shtetërore. Ato kanë oborrin e vet, në të cilin përfshihen feudalë të mëdhenj e të vegjël të nënshtruar; kanë ministrat e tyre të financave (protovestiarët), kancelarët (logofetët) dhe “dijakët”; administrojnë nëpërmjet qefalëve dhe vojvodëve. Në dokumentet e tyre, gjenden të tria gjuhët e shkruara të Evropës: latinishtja, greqishtja dhe sllavishtja.⁶⁰

Principata e Balshajve doli si një formacion shtetëror, me rol të rëndësishëm politik në trojet e Shqipërisë së sotme të Veriut në fillim të viteve 60- të të shekullit XIV dhe u bë faktorë me peshë në jetën ekonomike politike dhe ushtarake. Territori mbi të cilin shtrihej pushteti i Balshajve në fillim të vitit 60- të të shekullit XIV emërohej prej vetë balshajve apo edhe prej të huajve Zetë.⁶¹ Ky emërtim, nënkuptonte territoret rreth lumit Zetë.⁶² Në disa raste, Zeta përmendet si pjesë e Arbërisë.⁶³ Kështu, në vitin 1400, territoret deri në Kotorr përmenden brenda konceptit Arbëri⁶⁴

Edhe vetë Dushani, në një kartë të vitit 1349, e konsideronte Zetën si pjesë të Arbërisë.⁶⁵ Shkrimtari dhe filozofi Konstantin Filozof (rreth viteve 1380-1431), i cili ka shërbyer në oborrin mbretërorë të Rashës, bregdetin e Zetës e quante trevë arbërore (арбансказемла).⁶⁶ Në shekullin e XIV, këtu përmendet fshati Arbanas.⁶⁷ Medievisti frëng A. Dyselie, hedh idenë se rruga e krijimit të principatës së Balshajve që ajo e aleancave politike me familjet e fuqishme arbërore përreth, që realizoheshin si nëpërmjet lidhjeve martesore të djemve të Balsh plakut, ashtu edhe me njohjen e sundimit të Balshajve, nëpërmjet lidhjeve të vasalitetit.

Kjo rrugë, shton më tej ky studiues bëri që feudalët e fuqishëm të ruanin zotërimet e tyre, që shteti i balshajve të mos vuante nga konfliktet e brendshme, duke dhënë në të njëjtën kohë pamjen e një shteti të organizuar mirë dhe që feudalet vasalë t’i mbeteshin besnikë për një kohë të gjatë familjes së Balshajve në saj të politikës së saj të tolerueshme.⁶⁸ Vëllezërit Balshaj (Strazimiri, Gjergji I dhe Balsha II) shfaqen si zhupan në Zetë duke filluar nga viti 1360, së pari në Budua dhe Tivar, pastaj në Shkodër dhe Ulqin.⁶⁹

Pjesë e planit të Balshajve për forcimin e principatës së tyre, ishte edhe shprehja e vullnetit të tyre për të kaluar nga riti ortodoks në atë katolik. Në letrën që papa Urbani V (1362-1370), më 25 maj 1368, u dërgoi vëllezërve Balshaj, shprehej gëzimi i tij që vëllezërit kishin shprehur dëshirën të pranonin katolicizmin. Kështu, më 29 janar të vitit 1369, në praninë e ipeshkvit të Svaçit dhe të Drishtit, dominikanit Pjetër dhe fisnikut Pervoz nga Ulqini, e bënë betimin vëllezërit Balsha për kalimin e tyre në kishën katolike, duke e vënë secili prej tyre

⁵⁸ J. Drançolli, *Shteti mesjetar i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut*, Pejë, 2001, 77; I njëjti, “Rrënjët e qytetërimit iliro – shqiptar në Kosovë”, në: *Buletin i Fakultetit Filozofik*, nr. XXV/ 1995, Prishtinë, 1998, 170.

⁵⁹ S. Pulaha, “Shqiptarët dhe beteja e Fushë Kosovës e vitit 1389”, në: *Beteja e Kosovës 1389*, (Përmbledhje studimesh), Tiranë, 2005, 11.

⁶⁰ M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 28-29, 243.

⁶¹ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 21.

⁶² G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, Tiranë, 2009, 18.

⁶³ *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia, collegunt et digesserunt*, L. de Thaloczy, C. Jireček et E. de Sufflay, vol. II, Botues: Drejtoria e përgjithshme e arkivave të Shqipërisë, Tiranë & Revista Ekskluzive, Prishtinë, Tiranë, Prishtinë – 2002, dok. 509 (më tutje *Acta Albaniae*, I).

⁶⁴ Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355- 1443)*, 47.

⁶⁵ J. Drançolli, *Popullsia shqiptare e Kosovës dhe e trojeve të tjera në ish-Jugosllavi gjatë shekujve XV-XVII*, në: *Gjurmime albanologjike* (ser, e shk. his.), nr. 22- 1992, Prishtinë, 1994, 65.

⁶⁶ Gj. Berisha, *Arbërorët ndërmjet kishës perëndimore dhe asaj lindore gjatë shek XI – XV*, Prishtinë, 2015, 248.

⁶⁷ *Acta Albaniae*, I, dok. 798, 237-238; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, shek. VIII-XV, 143; M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 152.

⁶⁸ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 25

⁶⁹ M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 25, 238; I. Božić, *Shqipëria dhe shqiptarët në shekujt XIII, XIV dhe XV*, 46.

vulën e përbashkët në procesverbal. Ky veprim përbënte një hap të rëndësishëm në politikën e brendshme dhe të jashtme të principatës së tyre.⁷⁰

Kryezotërinjtë Balshaj, nuk ishin te vetmit të cilët kishin shprehur dëshirën që të riktheheshin në ritin katolik. Për këtë qëllim papa Urbani V, në vitin 1370, i kishte emëruar katër ipeshkvij në Arbëri,⁷¹ që të kujdeseshin për kthimin e skizmatikëve në grigjën e Zotit. Këtë të dhënë e gjejmë edhe te Raynaldi. Padyshim, fjala ishte për kthimin e atyre të cilët qenë të detyruar me presion ta lënë fenë e tyre të dikurshme.⁷² Duhet theksuar, se, për Balshajt arbëror, ortodoksia kishte qenë një fe e imponuar në kushtet kur qenë nën presionin sllav. Ata vepruan nën maskën e saj derisa arritën kulmin e fuqisë së tyre politike për të shmangur çdo goditje të mundshme nga fqinjët rasian dhe kisha e tyre.

Me kalimin e Balshajve në katolicizëm, shteti i tyre mori një fizionomi të dalluar nga shteti fqinj i Rashës dhe përcaktonte orientimin e zgjerimit të mëtejshëm të tij në trojet me popullsi arbërore.⁷³ Në periudhën e Principatës së Balshajve, janë ndërtuar mjaft objekte religjioze, kisha e manastire, një pjesë e të cilave ruhen edhe sot. Ato u ndërtuan në zonat rreth Liqenit të Shkodrës, në krahinën e Krajës, pastaj në qytetet bregdetare shqiptare si në Ulqin, Tivar dhe Budua.⁷⁴ Dihet se kisha e Shën Mërisë në Krajë, u pasurua mjaft nga dhuratat që mori nga Balsha III, në vitin 1417.⁷⁵

Si rezultat i fuqizimit të principatave të pavarura shqiptare, numri i porositësve të veprave të artit, rritet në mënyrë të ndjeshme. Më 1373, Araniti qëndis me ar e mëndafsh për manastirin e madh të Ballshit, një vepër të përsosur arti, epitafin e quajtur të Gllavinicës porositur nga Gjergj Balsha, në kishën e Shën Mitrit (Dhimitrit- B. M.) të Pejës na jepet portreti i princit arbëror Balshës me të birin (Gjergji I Balsha- B. M.).⁷⁶ Gjatë viteve 1371-1372, Balshajt u bënë zotërues të një territori të gjerë trojesh arbërore që shkonte nga kufijtë e Budës në veri, deri te ato të Himarës në jug, prej Adriatikut në perëndim, deri në Kriva Rijeka e Kostur në lindje, në mes të cilave mbeti si një ishull paqësor principata e Topiajve, që përfshinte edhe qytetin e Durrësit.⁷⁷

Në këtë kohë, papa i luti Balshajt që të ndihmonin argjipeshkvin e Tivarit, Gjonin.⁷⁸ Për të bashkuar territoret e Kosovës se sotme me zotërimet e tyre, Balshajt përdorën ekspeditën ushtarake. Në krye të një ushtrie, u nis vetë Gjergji I Balsha. Por veprimet luftarake këtu u përdoren fare pak dhe vetëm ndaj një rrethi të caktuar feudalësh, që bënë rezistencë në kështjella. Përkundrazi, popullsia i priti Balshajt si çlirimtar.⁷⁹ Sundimi i principatës u shtri në qytetin e Pejës, Prizrenit⁸⁰ dhe deri në Kriva Rekë, pranë Novobërdës.⁸¹

⁷⁰ M. Пурковић, *Авиџонске пале и српске земље*, 75-76.

⁷¹ M. v. Šufflay, *Die Kirchengestände im vortürkischen Albanien*, në: *Illyrisch – Albanische Forschungen*, I. Band, München und Leipzig, 1916, 244.

⁷² G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Ferizaj, 1986, 98

⁷³ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 42-43.

⁷⁴ V. Shtylla, *Figura historike iliro-shqiptare*, 51.

⁷⁵ M. v. Šufflay, *Die Kirchengestände im vortürkischen Albanien*, 235.

⁷⁶ Dh. Dhamo, Mbi disa tipare të përbashkëta të pikturës sonë të shejzëve XIII-XV, në: *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë, 1988, 108.

⁷⁷ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 45; I njëjti, *Kosova në shtetin feudal të shqiptar të Balshajve*, 110; A. Buda, *Gjergj Kastrioti-Skenderbeu dhe epoka e tij*, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 1969, 7; S. Pulaha, *Shqiptarët dhe ...*, 12; M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 25-26, 238.

⁷⁸ M. Пурковић, *Авиџонске пале и српске земље*, 84.

⁷⁹ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 46; I njëjti, *Kosova në shtetin feudal të shqiptar të Balshajve*, 115-116.

⁸⁰ J. Drançolli, *Vështrim mbi Kosovën gjatë feudalizmit të zhvilluar*, në: *Kosova-Kosovo*, Prishtinë, 1983, 308-309; S. Rizaj, *Kosova gjatë ...*, 22.

⁸¹ M. Орбини, *Краљевство Словена*, Београд, 1968, 64; L. Malltezi, *Qytetet e bregdetit...*, 50; Q. Dalipi, *Inkursionet osmane ...*, 68.

Studiuesi Biçoku, thekson se Balshajt u bënë zotërues të Novobërdës,⁸² por nuk përmend burimin ku është mbështetur. Përfshirja e territorit të Kosovës se sotme në shtetin e Balshajve, i jepte garanci të mëtejshme ekonomike si dhe e stimulonte atë. Pikërisht në saje të pritjes së favorshme që gjeti Gjergj Balsha në Kosovën e sotme, principata u zgjerua aty brenda një kohe të shkurtër.⁸³ Gjithashtu, princërit Balshaj, ndikimin e vet në këtë territor e shtrinë edhe në organizimin kishtar. Kështu, pjesëtarët e kësaj familje në vitet 1375 dhe 1385, udhëhoqën kuvendet kishtarë në Patriarkanën e Pejës, ndërsa pas vitit 1380, ia arritën qëllimit që qendrën e kishës serbe ta shpërngulin nga Peja për në Zhiçë,⁸⁴ prej nga ishte transferuar më parë këtu.

Një hap i tillë ishte i mirëseardhur, kur dihet se kisha rasiene kishte luajtur një rol mjaft destruktive, rol ky, i cili nuk kishte të bënte aspak me parimet fetare të krishterimit. Dihet se Sava Nemanja (rreth 1174-1235), në vitin 1219 e themeloi Kishën autoqefale të Rashës,⁸⁵ me qendër në Zhiçë,⁸⁶ ndërsa vendin e ndau në 8 peshkopata, dhe për peshkopë vendosi vetëm rasiene.⁸⁷ Deri në këtë kohë, kjo kishë varej nga Kryepeshkopata e Ohrit. Këtë ndarje e njohu perandori bizantin Teodor Laskari dhe patriku Manjoll i Kostandinopojës.⁸⁸ Mirëpo, këtë ndarje nuk e ka njohur Kryepeshkopata e Ohrit. Kisha e pavarur rasiene, sipas studiuesve serb, ka ndihmuar në luftë kundër agresionit papnor dhe feudalëve të Evropës Perëndimore.⁸⁹

Mirëpo, dokumentet e kohës, japin dëshmi të kundërta me këtë që pretendojnë studiuesit serb. Ato, dëshmojnë se kush në të vërtetë ishte viktima dhe kush agresori. Vetëm pas djegies së Manastirit të Zhiçës, nga një sulm i bullgarëve, tatarëve dhe kumanëve, në fund të shekullit XIII, selia e kryepeshkopatës u zhvendos në Pejë.⁹⁰ Krahas shpalljes së Perandorisë së Rashës, në vitin 1346, Kryepeshkopata rasiene u ngrit në shkallë patrikane me seli në Pejë.⁹¹ Persekutimin dhe konvertimin e popullsisë autoktone arbërore të besimit katolik, e kanë praktikuar sundimtarët rasiene. Rrjedhimisht, ato i sollën kishës arbërore vështirësi të shumta.

Kjo kishte bërë që kundër kësaj gjendje të vështirë, disa herë kishte reaguuar edhe vetë papati. Mirëpo, këto masa që ndërmerreshin nga sundimtarët rasiene, vareshin nga rrethanat e krijuara politike në rajon. Këtu po përmendim rastin e Stefan Dushanit (1331-1355), i cili, posa u forcua në pushtet, filloi t'i ndjekë katolikët në vendin e vet. Për të thuhet se ka qenë "mjaft jotolerant ndaj katolikëve sepse katolicizmin në popull dhe në masë nuk e duronte".⁹² Në kohën e marrëdhënieve të mira midis Balshajve dhe Papës së Romës, qyteti i Prizrenit në këndin lindor të Arbërisë veriore, fitoi një ipeshkëv katolik (rreth vitit 1372), por, për një kohë të shkurtër.⁹³ Mos lejimi i funksionimit të ipeshkvisë, për një kohë më të gjatë, na jep të kuptojmë për vështirësitë në të cilat ndodhej kisha katolike arbërore, nën sundimin Rasiene.

⁸² K. Biçoku, *Falangat që rrezikojnë kombin shqiptar*, Tiranë, 1999, 19.

⁸³ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 46-47

⁸⁴ P. Bogdani, *Kosova në shtetin feudal të shqiptar të Balshajve*, 114-118.

⁸⁵ *Cultural Heritage of Kosovo and Metohija*, Institute for protection of Cultural Monuments of the Republik of Serbia, Belgrade, 2002, 13, 33; M. Grujić, *Pravoslavna Srpska Crkva*, Beograd, 1921, 2-3.

⁸⁶ M. Grujić, *Pravoslavna Srpska Crkva*, 4; *Mala enciklopedija ...*, br. 1, f. 98, 110, 632; Z. Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, 162; M. Tërrnava, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, 1995, 21.

⁸⁷ *Mala enciklopedija ...*, br. 3, 110.

⁸⁸ M. Grujić, *Pravoslavna Srpska Crkva*, 1-3; Z. Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, 162.

⁸⁹ *Mala enciklopedija ...*, br. 3, 110-111; M. Grujić, *Pravoslavna Srpska Crkva*, 4-5, 12.

⁹⁰ *Cultural Heritage of Kosovo and Metohija*, 13, 33; *Mala enciklopedija ...*, br. 1, f. 98; G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, 86; V. Krestić, Đ. Lekić, *Kosovo i Metohija tokom vekova zublja*, Prishtina, 1995, 194.

⁹¹ *Cultural Heritage of Kosovo and Metohija*, 13; *Mala enciklopedija ...*, br. 1, 632; M. Grujić, *Pravoslavna Srpska Crkva*, 29-30.

⁹² M. Пурковић, *Авињонске паве и српске земље*, 49; G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, 95; P. Xhufi, *Heretikë shqiptarë në mbretërinë mesjetare serbe*, në: *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë, 1990, 100.

⁹³ M. v. Šufflay, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien*, 216, 231.

Balsha II, i shkoi në ndihmë Teodor Muzakës në luftë kundër sundimtarit sllav, Vukashinit. Ku korrën fitore në betejën pranë Kosturit (1372).⁹⁴ Kur ushtria osmane, me ftesë të Karl Topisë, hyrën në territorin e Balshajve në vjeshtë të vitit 1385, Balsha II i doli përpara me një ushtri 1000 vetash në zotërimet e tij në Myzeqe.⁹⁵ Në betejën e cila u zhvillua në fushën e Savrës më 18 shtator (Šufflay thotë në nëntor), ushtria e tij u thye dhe ai mbeti i vrarë.⁹⁶ Meqë Marin Barleti kur flet për Betejën e Savrës, nuk e potencon faktin se osmanët ishin të ftuar nga ana e Karl Topisë,⁹⁷ si dhe qëndrimi armiqësor i Karl Topisë ndaj osmanëve në vitet që pasuan, studiuesi Dalipi mohon mendimin se osmanëve u është bërë një ftesë e tillë.⁹⁸

Kjo ngjarje, ishte një goditje shumë e rëndë për shtetin unitar arbëror të Balshajve. Si pasojë, Principata e Balshajve, u nda në tri pjesë, mirëpo në Arbërinë e veriut u ruajt trangu bazë i principatës së Balshajve nën sundimin e Gjergjit II Strazimitit.⁹⁹ Ndihma që Gjergji II Balsha, u ofroi mbretit rasian Lazarit dhe banin e Bosnjës, Tverko, ishte vendimtare që në Bileçe (1388) të korret fitore kundër ushtrisë osmane.¹⁰⁰ Sipas kronistëve osmane, Gjergji II Balsha, kishte hyrë në koalicion në mënyrë të fshehtë dhe pa i prishur marrëdhëniet e vasalitetit.¹⁰¹

Gjithashtu, Gjergji II Balsha, marshoi me një ushtri të madhe arbërore në Fushën e Kosovës më 1389, në betejën e madhe në përpjekjet e koalicionit ballkanik për të ndalur invazionin osman.¹⁰² Prandaj, studiuesi Milutinović, gabon kur mohon pjesëmarrjen e këtij bujari në betejën e Kosovës.¹⁰³ Disfata në Betejën e Kosovës, krijoi një situatë më të vështirë, si për principatën e Balshajve, ashtu edhe për tërë territorin e Arbërisë. Papa Bonifaci IX, në një letër dërguar Gjergj Strazimitit, më 13 prill 1391, kishte kërkuar nga ai që të përpiquej që “qyteti i ... Durrësit dhe qytetarët e tij ... të largoheshin nga bindja e Gjergj Topisë dhe prej cilitdo tjetër skizmatik”.¹⁰⁴

Një gjendje të tillë në qytetin e Durrësit, e kishte mundësuar pazotësia e Gjergj Topisë, i cili ishte i sëmurë,¹⁰⁵ dhe kjo kishte bërë që në qytete të zhvillohej një luftë e brendshme politike me një maskë fetare; ndesheshin midis tyre përkrahësit e Papës së Romës Bonifacit IX (1389-1404) dhe të antipapës Klementit VII (1342-1394) që mbështetej nga perandori Hungarez Ludovik Anzhu. Anën e këtij te fundit, e kishte marrë edhe Gjergj Topija.¹⁰⁶ Në vitin 1391 Gjergj II Strazimiri ia ofroi simbolikisht tokat e veta Papës së Romës.¹⁰⁷

⁹⁴ Gj. Muzaka, *Memorje*, përgatitur nga Dh. Qiriazi, Tiranë, 1996, 28-29; Historia e Popullit Shqiptar, vëll. I, Tiranë, 2002, 302; P. Xhufi, *Shqiptarët e ...*, 104; K. Frashëri, Kush është Musa Arbanasi, në: *Beteja e Kosovës 1389* (Përmbledhje studimesh), Tiranë, 2005, 144.

⁹⁵ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 58; Shih edhe: M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 49, 133; P. Bartl, *Shqipëria – nga mesjeta deri sot*, Prizren, 1999, 35; P. Xhufi, *Shqiptarët e ...*, 105-106; Q. Dalipi, *Inkursionet osmane ...*, 72-73.

⁹⁶ M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 49, 133; P. Bartl, *Shqipëria – nga mesjeta deri sot*, 35.

⁹⁷ M. Barleti, *Rrethimi i Shkodrës*, Tiranë, 1967, 36.

⁹⁸ Q. Dalipi, *Inkursionet osmane ...*, 124-125.

⁹⁹ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 58; E. Jacques, *Shqiptarët*, Tiranë, pa vit botimi, 192.

¹⁰⁰ B. Milutinović, *Drivast u ...*, 387.

¹⁰¹ *Luftrat shqiptaro-turke në shek. XV*, Burime osmane, 77-78. Q. Dalipi, *Inkursionet osmane ...*, 74-75.

¹⁰² P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 59; S. Pulaha, *Shqiptarët dhe ...*, 21-22; A. Dyselje, A e kanë pushtuar shqiptarët Kosovën, në: *Kosova*, Prishtinë, 8/2000, 54; E. Jacques, *Shqiptarët*, 195; Q. Dalipi, *Inkursionet osmane ...*, 105-106; I njëjti, *Beteja e Kosovës (1389) dhe kontributi i shqiptarëve*, në: *Kosova*, nr. 27, Prishtinë, 2005, 52.

¹⁰³ B. Milutinović, *Drivast u ...*, 387-388.

¹⁰⁴ *Acta Albaniae*, II, dok. 465, 115; L. Malltezi, *Përpjekjet dhe synimet e Venedikut për pushtimin e Durrësit*, në: *Studime për epokën e Skendërbeut*, vëll. II, Tiranë, 1989, 139.

¹⁰⁵ J. Drançolli, *Marrëdhëniet e Raguzës me Durrësin prej shekullit IX deri në vitin 1501*, në: *Gjurmime albanologjike* (seria e shkencave historike), XII-1982, Prishtinë, 1983, 44-45.

¹⁰⁶ M. v. Šufflay, *Die Kirchengestände im vortürkischen Albanien*, 240.

¹⁰⁷ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 61.

Gjergji II Balsha u zu rob në vitin 1392 nga sulltan Bajaziti dhe u lirua vetëm pasi u dorëzoi turqve Shkodrën (kryeqendrën e shtetit të tij), Drishtin dhe Shën Shirgjin në Bunë.¹⁰⁸ Pas kësaj kryeqendër e princërve të familjes së bujarëve arbëror Balshajve u bë qyteti i Ulqinit.¹⁰⁹ Gjatë kësaj periudhe Ulçini përjetoi një lulëzim të plotë.¹¹⁰ Nuk ishte vetëm rreziku osman që kërcënonte principatën e Balshajve, por, Gjergjit II Strazimiri u deshtë të ballafaqohej edhe me sundimtarin e Zetës së epërme Radiq Cernojeviqin, Progon Dukagjinin, si dhe me presionin e Republikës së Venedikut.¹¹¹

Në betejën e cila u zhvillua në fushën e Rovinës, ku osmanët kishin pësuar disfatë kundër Perandorit të Hungarisë Sigismundit, në radhët e ushtrisë osmane, ishin vasalet: Konstantin Balsha,¹¹² pastaj prijësit rasian, Stefani, i biri i Llazarit, Marko, i biri i Vukashinit, i cili u vra në radhët e osmanëve, dhe Konstandin Dejanoviç.¹¹³ Gjergjit II Strazimiri e shfrytëzoi situatën për të rimarr Shkodrën dhe Drishtin.¹¹⁴ Gjergji II, njëmend i shporri turqit, mirëpo ishte i shtrënguar të venedikasit. Ai u dha atyre qytetin e Shkodrës dhe Drishtit.¹¹⁵

Formimi i një koalicioni forcash antiosmane nga ana e Sigismundit, e vuri në lëvizje edhe Gjergjin II. Nuk janë të rastësishme bisedimet që u bënë në Raguzë midis Banit të Kroacisë dhe djali të Gjergjit II, Balshës III, në fund të tetorit të vitit 1395, si dhe ato që u zhvilluan midis të dërguarve të tjerë të banit të Kroacisë me Gjergjin në Shkodër, në fillim të nëntorit të atij viti.¹¹⁶ Mbas luftës së pafat afër Nikopoljës (1396), duke qëndruar në Raguzë (21-28 dhjetor), mbreti Sigismund i dha Gjergjit II Balshaj titullin “princeps Albanie” dhe e emëroi zhupan të vetin mbi Korçullën e Hvarin. Këtë nderim, Gjergji e mbajti deri në fund të jetës së tij (prill B. M. 1403).¹¹⁷

Se më të vërtetë Balshajt ishin mjaft aktiv në organizimin e luftës kundër pushtuesve osmanëve, tregon edhe fakti se në vitin 1402, argjipeshkvi i Tivarit Marini, gjendej në Venedik si përfaqësues i Gjergj Balshës II, i cili kishte lejen e Republikës për të mbledhur ndihma në tokat e saj “mbasi të ardhurat e tij kishin shterure krejt nga invazioni turk (osman- B. M.)”.¹¹⁸ Principata e balshajve ballafaqohej me momentet më të vështira në historinë e saj, në kohën e Balshës III, i cili trashëgoi të atin në moshën 17 vjeçare.¹¹⁹ Qyteti i Ulqinit mbeti rezidenca e tij.¹²⁰

Në luftën kundër Venedikut, Balsha III, u ndihmua nga Gjergj Dukagjini, Stefan Maramonti i cili ishte njëherësh edhe kushëriri i Balshajve, pastaj Tanushi i Vogël, dukagjinas.¹²¹ Balsha III, në fillim të vitit 1415 i kërkoi Republikës së Venedikut, nëpërmjet një ambasadori të tij, që të lejojë atë që me trupat e veta të kalojë nëpër zotërimet venedikase, për të vajtur në ndihmë sundimtarëve arbërorë kundër pushtuesve osman.

¹⁰⁸ M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 49; S. Daci, *Lezha nën sundimin e Venedikut*, në: *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II, Tiranë, 1989, 153; B. Milutinović, *Borba Balšića sa Mlečanima za Zetske primorske gradove*, në: *Zbornik radova*, Filozofski Fakultet, nr. 26-27, Prishtina, 1997, 89; I. Božić, *Shqipëria dhe shqiptarët në shekujt XIII, XIV dhe XV*, 58.

¹⁰⁹ *Acta Albaniae*, II, dok. 485, 122.

¹¹⁰ R. Ushaku, *Ulqini në gjurmët e shekujve*, 18-19.

¹¹¹ L. Malltezi, *Qytetet e bregdetit...*, 57-60.

¹¹² P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 69.

¹¹³ G. Castellan, *Histori e Ballkanit*, Prishtinë, 1997, 71-72.

¹¹⁴ B. Milutinović, *Borba Balšića sa ...*, 89-90.

¹¹⁵ *Acta Albaniae*, II, dok. 544, 555, 145, 148.

¹¹⁶ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 70.

¹¹⁷ M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 227.

¹¹⁸ M. v. Šufflay, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien*, 253.

¹¹⁹ L. Malltezi, *Shkaqët e luftës së Balshës III kundër republikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV*, në: *Studime historike*, nr. 2, Tiranë, 1980, 176, 188.

¹²⁰ P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 92.

¹²¹ S. Daci, *Forcimi i familjeve feudale dhe zotërimet e tyre*, 164-169.

Kërkesa tjetër ishte që Venediku t'i njihte Balshës III, një privilegj që e kishte gëzuar më parë familja e tij për të ushtruar kujdestarinë në Kishat e Arbërisë.¹²² Në shekujt XIV dhe XV, kisha e krishterë ndër arbëror, e të dyja riteve, ishte faktor i rëndësishëm në ruajtjen e pavarësisë dhe te identitetit etnik arbëror. Ajo, së bashku me Gjergj Kastriotin Skënderbeun është pararojë e qytetërimit të krishterë evropian.¹²³ Në këtë kohë, i gjithë urdhri i benediktinëve në Arbëri, u vu në vijë të parë për t'i bërë ballë sulmit osman.¹²⁴ Natyrisht se, në këtë organizim, familja arbërore e Balshajve, luajti një rol mjaft të rëndësishëm në mbrojtje të vendit kundër pushtuesve osman.

Mendimi i studiuesit Bartl, se, në mesjetë ndër shqiptar (arbëror B. M.) nuk ekzistonte as një organizim kishtar,¹²⁵ duhet te merret me rezervë. Rolin mjaft të madh pozitiv të kryezotërinjve balshaj, në përpjekjet për të bashkuar territoret arbërore, i kishte vlerësuar mjaft lartë vetë Skënderbeu, kur, porsa filloi veprimtarinë e tij më 1443-1444, deklaronte se donte të realizonte planet politike të Balshajve dhe shpallte, se, vepronte si trashëgimtar i tyre në trojet arbërore.¹²⁶ Pas rënies së Kostandinopojës, Rashës dhe Bosnjës, Arbëria ishte shteti i krishterë, më i madh dhe i fundit në Ballkanin e sotëm.¹²⁷

Duhet shtuar se, edhe më parë, osmanlinjtë, të cilët dukeshin si të pamposhtur, pikërisht arbërori Gjergj Arianiti i kishte mundur, trupat superiore osmane, nga viti 1432¹²⁸ e deri më 1439. Fitore këto, të cilat kishin bërë bujë të madhe në vendet tjera Evropiane, si te Papa Eugjeni IV, Mbreti Alfonsi I i Napolit dhe Perandori Sigismund, të cilët e vunë Arianitin nën protektoratin e vet.¹²⁹ Nga kjo shihet se Evropa e krishterë, edhe më parë kishte vlerësuar lartë, luftërat e lavdishme të popullit tonë kundër osmanlinjve. Sikur është shprehur studiuesi Frashëri, se Evropës i vajtën nga Arbëria lajmet e para të fitoreve mbi armatat osmane.¹³⁰

Është plotësisht e kuptueshme se kjo rezistencë do te ishte e pamundur pa organizimin e mirëfilltë si të familjeve bujare arbërore ashtu edhe të kishës arbërore. Arbëria ishte një shtet i pavarur në kohën e Skënderbeut,¹³¹ i cili do t'iu rezistojë për një periudhë jashtëzakonisht të gjatë me sukses qoftë osmanëve (1443-1468),¹³² qoftë venedikasve, deri ne vdekje. Ai ia doli mbanë të themelonte një Shtet në kuptimin e vërtetë të fjalës: Një Shtet me administratë të rregullt sociale-ekonomiko-politiko-ushtarake.¹³³ Për 25 vjet me radhë nën udhëheqjen e këtij kapedani e burri shteti të sprovuar, arbërorët i bënë sfidë atij armiku që nuk kishin mundur t'u bënin ballë koalicione të gjera ballkanike.¹³⁴ Në këtë luftë, u kalitën më tej tiparet dalluese e të qëndrueshme të popullsisë arbërore të trashëguara brez pas brezi.¹³⁵

¹²² P. Bogdani, *Lufta e principatës së Balshajve ...*, 204-205

¹²³ Z. Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren-Zagreb, 1998, 166.

¹²⁴ M. v. Šufflay, *Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien*, 277.

¹²⁵ P. Bartl, *Shqipëria – nga mesjeta deri sot*, 49.

¹²⁶ P. Bogdani, *Prirjet drejt...*, 131.

¹²⁷ M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 33, 246-247; Sh. Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000, 60.

¹²⁸ *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, shek. VIII-XV, 260.

¹²⁹ P. Bartl, *Shqipëria – nga mesjeta deri sot*, 42; F. Babinger, *Fundi i arianitëve*, Tiranë, 2004, 22-23.

¹³⁰ K. Frashëri, *Shqiptarët në ...*, 121.

¹³¹ *Lexikon – Neues Universal Lexikon in Farbe von A – Z*, München, 1999, 16.

¹³² R. d' Angely, *Enigma*, Tiranë, 1998, 74; N. Malcolm, *Kosova- një histori e shkurtër*, 91; *Mala enciklopedija ...*, br. 1, 36; Th. W Arnold, *Historija e përhapjes ...*, 169; I. Božić, *Shqipëria dhe shqiptarët në shekujt XIII, XIV dhe XV*, 74-87.

¹³³ GJ. Gashi, Shën Frani në Arbëri nga viti 1219-1991, në: *Urtia*, nr. VII, 1/1998, (11), Prishtinë, 1998, 16; GJ. Gashi, *Vatikani dhe Arbëria*, Tiranë, 1998, 10.

¹³⁴ L. Malltezi, *Beteja e Fushë ...*, 57.

¹³⁵ D. Mehmeti, Epoka e Skendërbeut dhe roli i saj në konsolidimin e kombësisë shqiptare, në: *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë, 1988, 136.

Qytetet e fundit arbërore, te cilat ranë nën sundimin osman ishin, Ulqini dhe Tivari (1571).¹³⁶ Duhet shtuar se këto qytete arbërore, janë konsideruar si trup i huaj në shtetin e Duklës.¹³⁷ Vetë fakti se argjipeshkvi i Tivarit, Gjon Bruni, ishte në ballë të qëndresës kundër pushtuesve osman, bëri që egërsia osmane të ishte më e ashpër, jo vetëm te banorët e këtij qyteti, por edhe te besimtarët katolikë të Arbërisë.¹³⁸ Pasi që Argjipeshkvia e Tivarit, ka pasur rol të rëndësishëm në organizimin e kishës katolike në Arbëri.

Tani kur kisha katolike ndër arbërore ishte nën sundimin osman, populli humbi mbështetjen kryesore për çlirim e vendit nga osmanet. Megjithatë, përpjekjet serioze për t'u çliruar nga pushtuesit osman nuk munguan as gjatë shekujve të më vonshëm, por që rezultuan pa sukses. Studiuesi Valentini i ka dhënë vendin e merituar luftës së popullit shqiptar, duke theksuar se: "Shqipëria është pararoja e Evropës së krishterë kundër barbarëve (osmanlinjëve –B. M.).¹³⁹ Kisha katolike ka dhënë kontribut të pamohueshëm në ruajtjen e kulturës arbërore, identitetin dhe entitetin e saj. Për një konstatim të tillë, janë të vetëdijshëm të gjithë intelektualët e vërtetë dhe njerëzit e singertë dhe të ndershëm.¹⁴⁰ Kësisoj, rolin e bujareve Balshaj, në forcimin e kishës katolike nderë arbërore, duhet marrë si një përpjekje e mirë menduar dhe me se e nevojshme për konsolidimin dhe bashkimin e territoreve arbërore.

Përfundim

Familjet bujare arbërore filluan të forcoheshin në pjesën e dytë të shekullit XIV. Forcimi i tyre ngjalli shpresa të reja për forcimin e pozitës së popullsisë arbërore në trojet e tyre etnike. Një shpresë të tillë ngjalli edhe familja bujare e Balshajve, e cila ka luajtur një rol të rëndësishëm në rajon si faktorë me peshë të madhe politike dhe ushtarake. Vetë fakti se zotërimet e tyre përfshinin kufijtë e Budës në veri, deri te ato të Himarës në jug, prej Adriatikut në perëndim, deri në Kriva Rekë e Kostur në lindje, dëshmon për organizimin e tyre politik e ushtarak.

Në aspektin religjioz, Balshajt arritën të ndërtonin disa kisha në zonat rreth Liqenit të Shkodrës, në krahinën e Krajës, në Ulqin, Tivar dhe Budua. Në Kosovën e sotme, ku edhe kishin shtrirë sundimin e tyre, pjesëtarët e kësaj familje, udhëhoqën kuvendet kishtare në Patriarkanën e Pejës në vitet 1375 dhe 1385. Gjithashtu, në kohën e tyre, qyteti i Prizrenit fitoi një ipeshkëv katolik. Forcimi i Principatës së Balshajve, luajti një rol të rëndësishëm në frenimin e zgjerimit, dhunës të kishës ortodokse të Rashës ndaj popullsisë autoktone arbërore.

Referencat

- [5]. *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia, collegerunt et digesserunt*, L. de Thaloczy, C. Jireček et E. de Sufflay, vol. II, Botues: Drejtoria e përgjithshme e arkivave të Shqipërisë, Tiranë & Revista Ekskluzive, Prishtinë, Tiranë, Prishtinë – 2002.
- [6]. *Burime të zgjedhura të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, shek. VIII-XV*, vëll. II, përgatitur për shtyp nga: A. Buda, I. Zamputi, Tiranë, 1962.
- [7]. *Dokumentet e shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV, Tiranë, 1967.
- [8]. *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1479-1506)*, pjesa II (1499-1506), Tiranë, 1979.
- [9]. *Lufta shqiptaro-turke në shek. XV – Burime Osmane*, përgatitur për shtyp nga S. Pulaha, Tiranë, 1968, 296.
- [10]. Angely, d'. R., *Enigma*, Tiranë, 1998.
- [11]. Babinger, F., *Fundi i arianitëve*, Tiranë, 2004.
- [12]. Barleti, M., *Rrethimi i Shkodrës*, Tiranë, 1967.

¹³⁶ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për...*, 26; M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 173.

¹³⁷ *Enciklopedija Jugoslavije*, vëll. VII, Zagreb, 1968, 514; *Dokumentet e shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV, Tiranë, dok. 252, 175; *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1479-1506)*, pjesa II (1499-1506), Tiranë, 1979, dok. 42, 45.

¹³⁸ N. Malcolm, *Kosova- një histori e shkurtër*, 122.

¹³⁹ G. Z. Valentini, *Vepra I*, Përgatitur nga: K. Krisafi, N. Kulla, D. Thomollari, Tiranë, 2005, 652-653.

¹⁴⁰ *Historia e Kishës në popullin shqiptar*, Shkodër, 1994, 60.

- [13]. Bartl, P., *Shqipëria – nga mesjeta deri sot*, Prizren, 1999.
- [14]. Berisha, Gj., *Arbërorët ndërmjet kishës perëndimore dhe asaj lindore gjatë shek XI – XV*, Prishtinë, 2015
- [15]. Biçoku, K., *Falangat që rrezikojnë kombin shqiptar*, Tiranë, 1999.
- [16]. Biçoku, K., Shfrytëzimi i masave fshatare gjatë sundimit venedikas, në: *Studime historike*, nr. 4, Tiranë, 1975.
- [17]. Bogdani, P., “Kosova në shtetin feudal të shqiptar të Balshajve”, në: *E verteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë, 1990.
- [18]. Bogdani, P., *Lufta e principatës së Balshajve dhe e sundimtarëve të tjerë shqiptar kundër Venedikut në 20 vjetet e para të shekullit XV* (punim disertacioni, depozituar në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë), Tiranë, 1984.
- [19]. Bogdani, P., “Prijet drejt bashkimit shtetëror të trojeve shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XIV dhe në fillim të shek. XV”, në: *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë, 1988.
- [20]. Buda, A., Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe epoka e tij, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 1969.
- [21]. Castellani, G., *Histori e Ballkanit*, Prishtinë, 1997.
- [22]. *Cultural Heritage of Kosovo and Metohija*, Institute for protection of Cultural Monuments of the Republic of Serbia, Belgrade, 2002.
- [23]. Ćirković, S., “Albanci u ogledalu južnoslovenskih izvora”, në: *Iliri i Albanci*, SANU (odelenje istoriskih nauka), XXXIX/10, Beograd, 1988.
- [24]. Daci, S., “Forcimi i familjeve feudale dhe zotërimet e tyre në krahinën e Lezhës në shekujt XIII-XIV”, në: *Gjurmime albanologjike* (seria e shkencave historike), 13 - 1983, Prishtinë, 1984.
- [25]. Daci, S., Lezha nën sundimin e Venedikut, në: *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II, Tiranë, 1989.
- [26]. Dalipi, Q., *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355- 1443)*, Tetovë.
- [27]. Dalipi, Q., Beteja e Kosovës (1389) dhe kontributi i shqiptarëve, në: *Kosova*, nr. 27, Prishtinë, 2005
- [28]. Dalipi, Q., *Inkursionet osmane në trevat shqiptare deri më 1402*, Kërçovë, 2002.
- [29]. Dhamo, Dh., Mbi disa tipare të përbashkëta të pikurës sonë të shejve XIII-XV, në: *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë, 1988.
- [30]. Drançolli, J., Marrëdhëniet e Raguzës me Durrësin prej shekullit IX deri në vitin 1501, në: *Gjurmime albanologjike* (seria e shkencave historike), XII-1982, Prishtinë, 1983
- [31]. Drançolli, J., Popullsia shqiptare e Kosovës dhe e trojeve të tjera në ish-Jugosllavi gjatë shekujve XV-XVII, në: *Gjurmime albanologjike* (seria e shkencave historike), nr. 22- 1992, Prishtinë, 1994.
- [32]. Drançolli, J., “Rrënjët e qytetërimit iliro – shqiptar në Kosovë”, në: *Buletin i Fakultetit Filozofik*, nr. XXV/ 1995, Prishtinë, 1998.
- [33]. Drançolli, J., *Shteti mesjetar i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut*, Pejë, 2001.
- [34]. Drançolli, J., Vështrim mbi Kosovën gjatë feudalizmit të zhvilluar, në: *Kosova-Kosovo*, Prishtinë, 1983.
- [35]. Dyselje, A e kanë pushtuar shqiptarët Kosovën, në: *Kosova*, Prishtinë, 8/2000.
- [36]. *Enciklopedija Jugoslavije*, vëll. VII, Zagreb, 1968.
- [37]. Faveiral, K. Zh., *Historia e Shqipërisë*, Tiranë, 2004.
- [38]. Frashëri, K., Kush është Musa Arbanasi, në: *Beteja e Kosovës 1389* (Përmbledhje studimesh), Tiranë, 2005.
- [39]. Frashëri, K., “Shqiptarët në betejën e Kosovës”, në: *Beteja e Kosovës 1389* (Përmbledhje studimesh), Tiranë, 2005.
- [40]. Gashi, Gj., Shën Frani në Arbëri nga viti 1219-1991, në: *Urtia*, nr. VII, 1/1998, (11), Prishtinë, 1998.
- [41]. Gashi, Gj., *Vatikani dhe Arbëria*, Tiranë, 1998.
- [42]. Gelcich, G., *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, Tiranë, 2009.
- [43]. Grujić, M., *Pravoslavna Srpska Crkva*, Beograd, 1921.
- [44]. Gjini, G., *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Ferizaj, 1986.
- [45]. *Historia e Kishës në popullin shqiptar*, Shkodër, 1994.
- [46]. *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi I, Prishtinë, 1968.
- [47]. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllimi I, Tiranë, 2002.
- [48]. *Istorija Crne Gore*, II, Titograd, 1970.
- [49]. Jacques, E., *Shqiptarët*, Tiranë, pa vit botimi.
- [50]. Jagić, V., “Konstantin Filozof i njegov život Stefana Lazarevića, despota srpskoga”, në: *Glasnik srpskog učenog društva*, 42, Beograd, 1875.
- [51]. Laurasi, A., *Shteti dhe e drejta shqiptare ne epokën e Skënderbeut*, Tiranë, 1998.
- [52]. *Lexikon – Neues Universal Lexikon in Farbe von A – Z*, München, 1999.
- [53]. *Mala enciklopedija Prosveta*, treçe izdanje, br. 1, Beograd, 1978.
- [54]. Malcolm, N., *Kosova- një histori e shkurtër*, Prishtinë- Tiranë, 2001.
- [55]. Malltezi, L., Perpjekjet dhe synimet e Venedikut për pushtimin e Durrësit, në: *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II, Tiranë, 1989.

- [56]. Malltezi, L., *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas (Aspekte të jetës së tyre)*, Tiranë, 1988.
- [57]. Malltezi, L., Shkaqët e luftës së Balshës III kundër republikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV, në: *Studime historike*, nr. 2, Tiranë, 1980.
- [58]. Mehmeti, D., Epoka e Skendërbeut dhe roli i saj në konsolidimin e kombësisë shqiptare, në: *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë, 1988.
- [59]. Mijatović, Č., “Balšići (Skice za istoriju Zete)”, në: *Glasnik srpskog učenog društva*, knj. 49, Beograd, 1881.
- [60]. Milutinović, B., Borba Balšića sa Mlečanima za Zetske primorske gradove, në: *Zbornik radova*, Filozofski Fakultet, nr. 26-27, Prishtina, 1997
- [61]. Milutinović, B., Drivast u u vojno-političkoj situaciji XIV-XV veka (do 1478. godine), në: *Zbornik radova*, Filozofski Fakultet, nr. XXV, Prishtina, 1996.
- [62]. Mirdita, Z., *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren-Zagreb, 1998
- [63]. Muzaka, Gj., *Memorje*, përgatitur nga Dh. Qiriazi, Tiranë, 1996.
- [64]. Орбини, М., *Краљевство Словена*, Београд, 1968.
- [65]. Pulaha, S., “Shqiptarët dhe beteja e Fushë Kosovës e vitit 1389”, në: *Beteja e Kosovës 1389*, (Përmbledhje studimesh), Tiranë, 2005.
- [66]. Пурковић, М., *Авињонске пале и српске земље*, Пожаревац, 1934.
- [67]. Krestić, V., Lekić, Đ., *Kosovo i Metohija tokom vekova zublja*, Prishtina, 1995.
- [68]. Rizaj, S., *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982.
- [69]. Ruvarac, I., *O Knezu Lazaru*, Novi Sad, 1887.
- [70]. Schevill, F., *Ballkani- histori dhe qytetërimi*, Tiranë, 2002.
- [71]. Shtylla, V., *Figura historike iliro-shqiptare*, Tiranë.
- [72]. Skiro, Xh., Arbri mesjetar i Epirit në burimet bizantine, traktati etnologjik arbër i Nikollë Ketës (1741-1803), në: *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë, 1988
- [73]. Stratimirović, Đ., “O Balšićima”, në: *Godišnjica Nikole Čupića*, knj. XV, Beograd, 1895.
- [74]. Šufflay, M., *Serbët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2002.
- [75]. Šufflay, v. M., Die Kirchengzustände im vortürkischen Albanien, në: *Illyrisch – Albanische Forschungen*, I. Band, München und Leipzig, 1916.
- [76]. Tërri, M., *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, 1995.
- [77]. Tunmanin, J., “Kërkime në historinë e popujve të Evropës Lindore”, në: *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, përgatitur nga N. R. Çabej, Prishtinë, 1990.
- [78]. Ushaku, R., *Ulqini në gjurmët e shekujve*, Ulqin, 1991.
- [79]. Valentini, Z. G., *Vepra I*, Përgatitur nga: K. Krisafi, N. Kulla, D. Thomollari, Tiranë, 2005.
- [80]. Xhufi, P., “Shqiptarët e Jugut në betejën e Fushë-Kosovës”, në: *Beteja e Kosovës 1389* (Përmbledhje studimesh), Tiranë, 2005.
- [81]. Zamputi, I., Autonomitë e qyteteve shqiptare të principatës së Balshajve dhe pasojat negative të pushtimit venedikas – Fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV, në: *Studime historike*, nr. 3, Tiranë, 1980.
- [82]. Zefi, Sh., *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000.